



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2021

VENDIM
Nr. 239, datë 02.06.2021

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 90/3, 95 të Kodit të Procedurave Administrative, në Kodin e Procedurës Penale, i ndryshuar, në Kodin e Procedurës Civile, i ndryshuar, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

V E N D O S I :

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

A. GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË VLORË

1. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë si vijon:

1.1 Kërkesës nr. 230 prot., datë 26.04.2021, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: paditëse: {...}palë e paditur: {...}, objekt: “Përmbushje detyrimi”;

1.2 Kërkesës nr. 247 prot., datë 04.05.2021, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: paditës: {...}, e paditur: {...}, person i tretë: KLSH, objekti: “Detyrimin e palës së paditur të kthejë shumën e përfituar për punime të pakryera ndaj palës paditëse në vlerën prej 1.312.791 lekë, në bazë të rekomandimeve të KLSH-së”.

B. GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR

1. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës së Gjykatës së Apelit Gjirokastrë si vijon:

1.1 Kërkesës nr. 366 prot., datë 05.06.2021, për caktimin e një gjyqtari, në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Ankues: {...}; Objekti: “Kundërshtim vendim për mosfillimin e procedimit penal”.

C. GJYKATA E APELIT KORÇË

1. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës së Gjykatës së Apelit Korçë si vijon:

- 1.1 Kërkesës nr. 587 prot., datë 27.05.2021, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Ankues: {...}, kundër: {...}; Objekti: “Kundër vendimit për mosfillimin e procedimit penal nr.439, viti 2020 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec”.

D. GJYKATA E APELIT SHKODËR

1. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës së Apelit Shkodër si vijon:

- 1.1 Kërkesës nr.821 prot., datë 04.05.2021, për caktimin e një gjyqtari, në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Kërkues: {...}; Objekti: “Pushim gjykimi”;
- 1.2 Kërkesës nr. 929 prot., datë 19.05.2021, për caktimin e një gjyqtari, në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Kërkues: {...}; Objekti: “Pushimin e çështjes”;
- 1.3 Kërkesës nr.1001 prot., datë 27.05.2021, për caktimin e dy gjyqtarëve, në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Kërkues: {...}; Objekti: “Heqje e sekuestros preventive”;
- 1.4 Kërkesës datë 31.05.2021, për caktimin e tre gjyqtarëve, në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Kërkues: Prokuroria Shkodër; Të pandehur: {...}, {...}; Akuza: “Për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga nenet 288/a/2 etj, të Kodit Penal”;
- 1.5 Kërkesës nr.994 prot., datë 27.05.2021, për caktimin e dy gjyqtarëve, në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Kërkues: {...}; Objekti: “Përjashtim gjyqtari”.

DH. GJYKATA E APELIT VLORË

1. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës së Gjykatës së Apelit Vlorë si vijon:

- 1.1 Kërkesës nr.396 prot., datë 05.05.2021, për caktimin e dy gjyqtarëve, në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Ankues: {...}, personi i tretë: Shoqëria {...}sh.p.k; Objekti: “Kundërshtim veprimesh përmbarimore”;
- 1.2 Kërkesës nr.397 prot., datë 05.05.2021, për caktimin e dy gjyqtarëve, në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Ankues: {...}, personi i tretë: {...}; Objekti: “Kundërshtim veprimesh përmbarimore”;
- 1.3 Kërkesës nr.428 prot., datë 18.05.2021, për caktimin e një gjyqtari, në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Kërkues: {...}; Objekti: “Përjashtim gjyqtari”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, **Miranda Andoni, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen penale me Ankues: {...}; Kundër: {...}; Objekti:**

- 2.1 Kundër vendimit datë 18.05.2020 ‘Për mosfillimin e procedimit penal’ të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, sipas kallëzimit penal nr. 954, datë 11.05.2020;

2.2 Kundër vendimit datë 10.03.2020 ‘Për mosfillimin e procedimit penal’ të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, sipas kallëzimit penal nr. 483, datë 20.02.2020.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, **Enton Dhimitri**, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen penale me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë; Person i interesuar: {...}, {...}, {...}; Objekti: Pushim i procedimit penal nr. 957/2018.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR